



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-8051/1 të datës 30.08.2022, është formuar sipas denoncimit të dorëzuar kundër drejtorit të ----- për realizimin e shpalljes për nevojat e -----, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent ndaj rastit për arsye se pretendimet e theksuar në denoncim nuk janë vërtetuar.

Lënda me numër 12-8051/1 të datës 30.08.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur më 30.08.2022 është dorëzuar denoncim kundër drejtorit të ----- për realizimin e shpalljes për nevojat e ----- dhe është formuar lënda me numër 12-8051/1 të datës 30.08.2022.

Në denoncim parashtruesi thekson se të njëjtën e dorëzon kundër drejtorit të ----- dhe kundër komisionit të formuar nga ana e drejtorit që i realizon intervistë gjat procedurave për punësim dhe i rangon kandidatët sipas listave të parashtruara nga partitë politike në pushtet. Në vijim thuhet se ata kandidatë marrin nga 20 pikë, kurse pjesa tjetër 10 e më pak, në mënyrë që emrat e paraqitur më parë të renditen të parët. Si shembull, procedura për pritjen e operatorëve në ----- botuar me numrin e shpalljes ----- . Më poshtë janë shembuj të kandidatëve me kode ID, të cilët pasi marrin 20 pikë nga një intervistë, ngjiten në renditje dhe futen

kandidatët për punësim. Parashtruesi thekson se një pikëzim i tillë pa arsyetim lë hapësirë për korrupsion, prandaj raporti dorëzohet për të hetuar punën e drejtorit dhe komisionit.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe përcaktimit të gjendjes faktike me rastin e denoncuar, KSHPK-ja ka dorëzuar kërkesë për mbledhjen e informatave në ----- dhe në Inspektoratin shtetëror administrativ.

Inspektorati Administrativ Shtetëror, me kërkesë të KSHSK-së, ka kryer një inspektim të jashtëzakonshëm më datë 26.09.2022, lidhur me zbatimin e procedurës së punësimit në ----- ----- me shpallje publike ----- për punësim prej 24 nëpunësve shtetëror. Në procesverbalin e mbikëqyrjes së kryer citohet dokumentacioni në të cilin është kryer inspektimi dhe jepet pasqyra e të gjitha veprimeve të kryera në procedurën e punësimit. Njëkohësisht, gjatë periudhës së mbikëqyrjes, procedura nuk ka përfunduar ende për shkak të paraqitjes në Agjencinë e Punësimit të RMV-së, pra nga gjithsej 24 nëpunës shtetëror, 12 të tjerët do të paraqiten më 3 tetor 2022. Njëkohësisht në procesverbalin e mbikëqyrjes së kryer nuk janë konstatuar parregullsi në funksionimin e subjektit të mbikëqyrjes.

Nga të gjitha konstatimet e mësipërme, KSHPK-ja konstatoi se pretendimet në fjalë nuk ishin vërtetuar, pas së cilës vlerësoi se nuk kishte elemente për veprime të mëtejshme dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: B.K.SH
Miratoi: Mr. SH.S anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

**Nënkryetar,
Katica Nikolovska**